

Bazuar në nenin 20 paragrafi 1 alineja 1 dhe 15 nga Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ φ 184/13, 33/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16 dhe 132/17) dhe nenin 10 paragrafet 1 dhe 3 dhe nenin 39 paragrafi 1 alineja 1 dhe 15 nga Rregullorja për punë e Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele nr.01-4351/1 nga 29.08.2014,në lidhje me nenin 14 nga Ligji për media dhe nenin 51 paragrafi 1 nga Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele,drejtori i Agjencisë më 9 tetor 2018, miratoi

**UDHËZUES
PËR PLOTËSIMIN E DETYRIMEVE PËR IMPRESIUM DHE
INFORMACIONE NË DISPOZICION TË PËRDORUESVE
1. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

1. Ky Udhëzues përcakton mënyrën e veprimit të transmetuesve gjatë kryerjes së detyrimeve nga neni 14 të Ligjit për media (Impresum) dhe neni 51 paragrafi 1 nga Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele (Informacione në dispozicion të përdoruesve).
2. Detyrimet për sigurimin e impresumit dhe informacionet të disponueshme për përdoruesit vlejnë për të gjithë transmetuesit.
3. Të dhënat për impresum shpallen në vendin e duhur (në shpicën lajmëruese ose ç'lajmëruese) në të gjitha programet e emituara pa marrë parasysh se bëhet fjalë për prodhimin e tyre (prodhuar nga vet transmetuesit, në koproduksion ose i kanë porositur) ose për program (të blerë) të huaj.

II.DETYRIMET PËR SHËRBIMET PROGRAMORE TELEVIZIVE

Informacione në dispozicion të përdoruesëve

4. Televizionet për t'u ofruar përdoruesëve qasje të lehtë, të drejtpërdrejtë dhe të përhershëm në të dhënat nëpërmjet të cilit do të mund të identifikohen dhe të kontaktojnë me ta, të paktën njëherë në ditë (mundësisht në fillim të pjesës së programit të mëngjesit) në telop, me kohëzgjatje të paktën 10 sekonda, për të publikuar të dhënat e mëposhtme të identifikimit të shërbimit programor:
 - Emri i ofruesit të shërbimeve mediatike audiovizuele;
 - Emri me të cilin identifikohet shërbimi programor;
 - Adresa e selisë dhe redaksia e medias;
 - Emri dhe mbiemri i personit përgjegjës të medias;
 - Emri dhe mbiemri i redaktorit përgjegjës, gjegjësisht të redaktorëve , në përputhje me organizimin e brendshëm të redaksisë;
 - Të dhënat e kontaktit me mediumin – të paktën numrin e telefonit, adresa e postës elektronike dhe/ose veb faqen;
 - Emri i organit rregullator kompetent.

Impresum

- 5, Televizionet në programet e lajmeve ditore (ditaret,lajme etj) dhe tek emisionet e tjera informativetë përbëra nga më shumë artikuj gazetaresk,nga prodhimi i tyre,impresiumi e publikon ashtu që:

- Në ç'lajmërimin e titullit kryesor do ti publikojnë të dhënat në vijim
 - Emri dhe mbiemri i redaktorit përgjegjës të shërbimit programor;
 - Emri dhe mbiemri i redaktorit përgjegjës të redaksisë informative (nëse ka);
 - Emri dhe mbiemri i redaktorit përgjegjës të botimit konkret të ditarit/lajmet/emisioni informativ;
 - Emri dhe mbiemri i anëtarëve të tjerë të ekipit televiziv me angazhman të rëndësishëm në përgatitjen e emisionit;
 - Data e produksionit (dita, muaji dhe viti);
 - Emri i subjektit tjetër nga i cili është marrë përmbajtja e caktuar ose pjesë e caktuar ose pjesë e përmbajtjes, nëse me marrëveshje reciproke nuk është rregulluar ndryshe;

 - Gjatë emisionit për çdo artikull të veçantë, do t'i publikojnë të dhënat në vijim:
 - Emri dhe mbiemri i gazetarit – autor i artikullit të publikuar:

 - Emri dhe mbiemri i personave të tjerë me angazhman të rëndësishëm për prodhimin e artikujve (kameraman, montazhist etj.)
6. Tek programet tjera të prodhuara vet, impresiumi publikohet ashtu që:
- Në lajmërimin dhe ç'lajmërimin e shpicës publikohen të dhënat në vijim:
 - Emri dhe mbiemri i redaktorit përgjegjës të shërbimit programor;

 - Emri dhe mbiemri i redaktorit përgjegjës të redaksisë nga i cili rrjedh programi (nëse ka);
 - Emri dhe mbiemri i redaktorit /autorit/drejtuari i emisionit/;

 - Emri dhe mbiemri i bashkautorëve, përkatësisht i gjithë ekipi televiziv me pjesëmarrje në tërësin e veprës audiovizuale;
 - Emri i subjektit që ka prodhuar programin (vetë transmetuesi, koproducentët, producenti i pavarur të cilit i është porositur programi);
 - data e produksionit (muaji dhe viti).

 - Nëse është e aplikueshme duhet të publikohen edhe të dhënat për:
 - Emri i personit juridik, përkatësisht emri dhe mbiemri i personit të mirën e kulturës së shfrytëzuar ose veprë arkivore, përkatësisht reproduktionin e veprës;
 - Emri i një subjekti tjetër nga i cili është marrë kontribut i caktuar ose një pjesë e kontributit, nëse në marrëveshje reciproke nuk është rregulluar ndryshe.
7. Kolazh i programeve argëtuese-informative ose informative - argëtuese (të mëngjesit, pasdites etj.) të transmetuara me të njetin titull, e përbërë nga disa njësi të veçanta, përveç impresiumit të programit, televizioni duhet:
8. Obligimin për publikimin e impresiumit nuk zbatohet për emetimin e spoteve muzikore veç e veç.
9. Ky obligim zbatohet për veprat audiovizive të përbëra nga një seri videoklipesh të krijuara në një njësi të veçantë programore nëpërmjet ndërhyrjes gazetareska/redaktive..

10. Kur emetohet program i prodhimit të huaj televizioni duhet të emetoj shpicën origjinale..
11. Nëse programet e prodhimit të huaj nuk janë të sinkronizuara të dhënat për ekipin që ka përshtatur programin për audiencën maqedonase duhet publikohen së bashku me ekipin original, dhe jo në vend të tyre.
12. Nëse programet janë me titra,në shpicën ç'lajmëruese, sëbashku me të dhënat për ekipin original duhet të publikohen të dhënat se kush e ka bërë përkthimin dhe përpunimin (emir i produksionit/personi/televizioni etj.),

III.OBLIGIMET PËR SHËRBIME PROGRAMORE RADIOFONIKE

Informacione të disponueshme për përdoruesit

13.Radiot,për t'u siguruar përdoruesëve akses të lehtë,të drejtpërdrejtë dhe të përhershëm në të dhënat përmes të cilave do të mund t'i identifikojnë dhe të kontaktojnë me to,duhet të publikojnë të paktën njëherë në ditë (mundësisht në fillim të programit të mëngjesit) të I publikojnë të dhënat në vijim për identifikimn e shërbimeve programore:

- ' Emri i transmetuesit të audio dhe shërbimeve mediatike;
- Emri me të cilin identifikohet në shërbimin e programit;
- Frekuencat përmes të cilave transmetohet programi;
- Adresa e selisë dhe readaksisë së mediumit;
- Emri dhe mbiemri i personit përgjegjës të medias;
- Emri dhe mbiemri i kryeredaktorit, përkatësisht redaktorëve, në përputhje me organizimin e brendëshëm të redaksisë;
- “ Detajet e kontaktit të medias – të paktën numrin e telefonit, adresën e postës elektronike dhe/ose faqen e internetit;
- Emri i organit rregullativ kompetent.

Impresium

14.Radiot, në forma e gjata të emisioneve informative ditore (radio Ditaret etj.) dhe në emisionet e tjera informative të përbëra nga disa shkrime gazetareske, nga prodhimi I tyre, e publikojnë impresiumin kështu që:

- Në shpicën ç'lajmëruese i publikojnë të dhënat në vijm:
- _Emri dhe mbiemri I redaktorit përgjegjës të shërbimit programor;
- Emri dhe mbiemri I redaktorit përgjegjës të redaksisë (nëse ka);

- Emri dhe mbiemri I redaktorit përgjegjës të edicionit konkret të programit të përditshëm/emisioni informativ;
- Emri dhe mbiemri I anëtarëve të tjerë të ekipit të radios me angazhman të caktuar në prodhimin e emisionit;
- Data e produksionit (dita, muaji dhe viti);
- Emri I një subjekti tjetër nga I cili është marrë një kontribut ose pjesë e caktuar e një kontributi, për veç rasteve kur nuk është rregulluar ndryshe me marrëveshje reciproke.
- Gjatë emisionit, në fillim ose në fund të çdo shkrimi të veçantë, do të publikojnë emrin dhe mbiemrin e gazetarit – autor I shkrimit të publikuar;
- Emri dhe mbiemri I personave të tjerë me angazhim të rëndësishëm në përgatitjen e shtojcave (kameraman, montazhist etj.) publikohen në shpicën ç'lajmëruese të emisionit

15. Në raste kur njësitë editoriale transmetohen nga lajmet të shkurtra radio lajme (flesh lajme më të shkurtra se 5 minuta, mjafton që në shpicën ç'lajmëruese të publikohen të dhënat në vijim:

- Emri dhe mbiemri I redaktorit të edicionit konkret të lajmeve;
- Emri dhe mbiemri I folësit/gazetarit;
- Emri dhe mbiemri I përgjegjësit të drejtimit teknik të emisionit;
- Data e produksionit (dita, muaji dhe viti);
- Emri I subjektit tjetër nga I cili është marrë një kontribut I caktuar ose një pjesë e një kontributi, përveç nëse nuk është rregulluar ndryshe me marrëveshje reciproke.

16. Në programet e tjera të prodhimit vetjak, impresiumi publikohet në atë mënyrë që:

- Në shpicën lajmëruese ose ç'lajmëruese publikohen të dhënat në vijim:
 - Emri dhe mbiemri I redaktorit përgjegjës të shërbimit programor;
 - Emri dhe mbiemri I redaktorit përgjegjës të redaksisë nga e cila buron programi (nëse ka);
 - Emri dhe mbiemri I redaktorit/autorit/drejtuesit të emisionit;
 - Emri dhe mbiemri I bashkautorëve, përkatësisht I gjithë ekipit të radios me pjesëmarrje në tërësinë e audio veprës;
 - Data e produksionit (muaji dhe viti);
 - Nëse është e aplikueshme, duhet të publikohen edhe të dhënat për:
 - Emri I personit juridik, përkatësisht emir dhe mbiemri I personit që ruan pasurinë kulturore të përdorur ose veprën arkivore, përkatësisht riprodhimin e veprës;
 - Emri I subjektit tjetër nga I cili është marrë një bashkëngjitje ose pjesë e caktuar nga shtojca, nëse nuk është rregulluar ndryshe me marrëveshje reciproke.

17. Tek blloqet programore/rripat (programi I mëngjesit, I mesditës, I pasditës, I natës etj.) radiot duhet:

- Në shpicën lajmëruese ose ç'lajmëruese të publikojnë të dhënat në vijim:
 - Emri dhe mbiemri I redaktorit përgjegjës të shërbimit programor;
 - Emri dhe mbiemri I drejtuesit të bllokut programor/rripit;

- Emri dhe mbiemri I personit përgjegjës për udhëheqjen teknike të emisionit dhe nëse është e aplikueshme ilustruesi muzikor dhe anëtarët e tjerë të ekipit me angazhman të caktuar në përgatitjen e bllokut programor (montazh, regjistruar zëri, etj.);
 - Data e produksionit (muaji dhe viti);
 - Emri I subjektit tjetër nga i cili është marrë një kontribut I caktuar ose pjesë e një kontributi,përveç nëse nuk është rregulluar ndryhse me marrëveshje reciproke.
- Në blloqet programore/rripat përveç impresiumit për rripin programor, radiot duhet:
 - Për çdo emision individual,të emituar në kornizën e bllokut programor të publikojë impresium;
 - Për çdo bashkëngjitje individuale,të publikoj të dhënat në vijim:
 - Emri dhe mbiemri I gazetarit – autor I shtojcës së botuar dhe I personave të tjerë me angazhman të rëndësishëm në realizimin e një artikulli (regjistruar I zërit,montazhist etj.),nëse janë të ndryshëm nga ekipi I atij botimi të bllokut.

18. Obligimi për të publikuar impresium nuk zbatohet për transmetimin e pjesëve muzikore individuale.

19. Ky detyrim vlen edhe për audiovepra të përbëra nga një seri pjesësh muzikore të konceptuara në një njësi të veçantë programore përmes ndërhyrjes gazetareske/redaktive.

20. Kur emeton program të prodhimit tuf, radiot duhet të emitojnë shpicën origjinale.

21. Nëse radio në njëfarë mënyre I përpunojnë programet nga prodhimi I huaj (përkthim,sinkronizim etj.),në shpicën ç'lajmëruese së bashku me të dhënat për ekipin origjinal,duhet të publikohen të dhënat se kush e ka bërë përpunimin.

IV. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

22. Ky udhëzues hynë në fuqi në ditën e miratimit dhe do të publikohet në faqen e internetit të Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele.

Бр. 01-4443/1

09.10.2018 година Скопје



